

Në përputhje me kërkesat nga neni 33 i Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë në Kosovë, Themeluesit e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar më dt. 25.11.2021 nxjerrin :

STATUTIN

E

“ FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SHPK

**Rr. Tirana, Objekti i Prime Group, C4/3 Llamella D, kati II nr 4, Prishtine
Kosove- Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Me këtë Statut rregullohen këto çështje :

- emërtimi i Shoqërisë,
- lloji i shoqërisë,
- adresa e selisë së saj,
- periudha e kohëzgjatjes,
- veprimtaria e shoqërisë,
- llojet e aksioneve të autorizuara për emetim, vlerën e tyre nominale, numrin dhe të drejtat e bartësve të tyre,
- organet drejtuese,
- emrat dhe adresat e themeluesve dhe
- procedurat me të cilat mund të ndryshohen rregulloret.

Neni 2

EMËRTIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Emërtimi i plotë i shoqërisë është : Shoqëria Tregtare “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS” shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
Emri tregtar : “FUENTE DYNAMICS”sh.p.k.

Neni 3

LLOJI I SHOQËRISË

Shoqëria Tregtare është Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ,shkurtimisht **SH.P.K.**

Neni 4

ADRESA E SELISË

4.1. Selia e "FUENTE DYNAMICS" sh.p.k është në Rr. Tirana, Objekti i Prime Group, C4/3, Llamella D, Kati II, nr.4, Prishtine, Kosove

4.2. **Agjent i regjistruar** i kësaj shoqërie tregtare është Admir Bytyci , i cili është agjent i ligjshëm për pranimin e shërbimeve, njoftimeve, kërkesave si dhe akteve tjera që dërgohen nga autoritetet publike.

4.3 Shoqëria mund të themeloi filiala, zyra përfaqësimi brenda vendit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

QËLLIMI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

Qëllimi i themelimit të Shoqërisë është qëllim i ligjshëm afarist, si dhe përfitimi personal dhe ndihma vendit ku jetojnë me kontribute dhe taksa të ndryshme

Neni 6

PERIUDHA E KOHËZGJATJES SË SHOQËRISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë si sh.p.k. do të jetë në afat të pacaktuar

Neni 7

VEPRIMTARIA E SHOQËRISË

Veprimtaria e Shoqërisë është :

- 3514 Tregetimi i Energjisë
- 7022 Aktivitetet të këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera për menaxhim
- 3512 Transmetimi i energjisë elektrike
- 7112 Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillimit teknik
- 3513 Shpërndarja e energjisë elektrike
- 7111 Aktivitetet e arkitekturës

Të gjitha veprimtaritë e Shoqërisë regjistrohen tek Zyra e regjistrimit e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 8

THEMELUESIT E SHOQËRISË

10.1. Themeluesit e shoqërisë mund të jenë persona fizik ose juridik, që kanë vënë ose do të kenë në zotërim aksione të shoqërisë ,me të gjitha mënyrat e parashikuara me ligj.

10.2. Themelues janë :

1. Fatbardha Bytyci Rr Osman Myderizi nr 7 Sh 3/33 , Tirane Shqiperi

10.3. Pronësia mbi aksionet e shoqërisë,përmban aderimin me të drejta të plota në statutin e shoqërisë nëpërmes përfaqësimit në Kuvendin e Aksionarëve.

Neni 9

TË DREJTAT DHE DETYRAT E THEMELUESVE

11.1. Interesat pronësore që mund të quhen “aksion” në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar janë njësitë në bazë të cilave bëhet ndarja e pronësisë në shoqëri.

11.2. Një interes pronësor në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar është pronë personale e pronarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tërësi, varësisht nga kufizimet e parapara në këtë Statut dhe kufizimet e tjera të përcaktuara në Marrëveshjen e shoqërisë.

11.3. Themeluesit e shoqërisë janë përgjegjës për të gjitha borxhet e shoqërisë dhe detyrimet e tjera me të tëra asetet.

11.4. Të gjithë themeluesit apo ndonjeri prej tyre që ndërmarrin veprim në emër të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar duke bërë hapjen e xhirollogarive bankare, blerjen dhe dhënjën me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve tjera , janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për pretendimet dhe detyrimet që lindin si rezultat i këtyre veprimeve.

11.5. Çdo aksionar ,ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndashme të shoqërisë dhe përfiton proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotëron .

11.6. Çdo vonesë në derdhjen e shumave të duhura nga shumat e pashlyera të aksioneve sjell pagimin e interesave,me përqindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimet personale që shoqëria mund të ushtroj ndaj aksionarit që nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga legjisllacioni në fuqi.

Neni 10

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

1. Kuvendi i aksionarëve
2. Drejtori apo Drejtorët Menaxhues.

Shoqëria mund të krijoj dhe mbajë edhe një Bord të drejtorëve.

Neni 11

Kapitali Aksionar dhe Kuvendi i aksionarëve

- 13.1. Kapitali aksionar perbehet nga 223398 aksione me vlere nominale 1 Euro per aksion pra vlere totale **223,398.00 Euro**.
- 13.2. Aksionet jane ne pronesi te Fatbardha Bytycit ne pjesen 100%
- 13.3. Kuvendi i aksionarëve, qoftë i zakonshëm apo i jashtëzakonshëm ka kompetenca dhe merr të gjitha vendimet e përcaktuara me Ligjin per shoqëritë tregtare ose Statut.
- 13.4. Kuvendi i aksionarëve do të mbahet në zyrën e regjistruar të shoqërisë ose në një vend tjetër të caktuar më parë me paralajmërimin për mbledhje.

Neni 12

E drejta e votës

- 14.1. E drejta e votës rrjedh nga zotërimi i aksioneve që përfaqësojnë dhe çdo aksion të jep të drejtën e të paktës një(1) vote.
- 14.2. E drejta e votës që rrjedh nga përfaqësimi ,kërkon një mandat përfaqësimi të shkruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 13

Drejtimi i mbledhjeve të Kuvendit

- 15.1. Thirrja e mbledhjes së Kuvendit bëhet :
 - nëpërmes njoftimit të dërguar me letër rekomande në adresën e çdo aksionari me shpenzimet e shoqërisë apo
 - ne menyre elektronike ne email adresat e aksionareve ku patjeter duhet konfirmimi.
- 15.2. Mbledhjet e Kuvendit të aksionarëve ,drejtohen nga një Kryesues i caktuar nga Kuvendi.
- 15.3. Gjithashtu mbledhjen e Kuvendit mund ta drejtojne personat që kane autorizim e ne pajtueshmëri me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 15.4. Kryesuesi cakton një procesmbajtës për të mbajtur procesverbalin lidhur me pikat e rendit të ditës.

Neni 14

Procesverbalet e mbledhjes së Kuvendit

- 16.1. Procesverbalet e mbledhjes së Kuvendit,duhet të mbahen në përputhje me kërkesat e Ligjit për shoqëritë tregtare dhe detyrimisht në fund të saj ,duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi dhe procesmbajtësi.

16.2. Kuvendi i jashtzakonshëm mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë në mbledhjen e parë të paktën $\frac{1}{2}$ e aksioneve dhe në të dytën $\frac{1}{4}$ e aksioneve me të drejtë vote. Në mungesë të këtij kuorumi mbledhja e dytë e Kuvendit mund të shtyhet për një datë të mëvonshme jo më të largët se dy muaj nga data e thirrjes së parë. Ajo merr vendim me një shumicë votash prej $\frac{3}{4}$ që u përkasin aksionerëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

16.3. Kuvendi i zakonshëm merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë, vetëm nëse aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë $\frac{1}{4}$ e aksioneve me të drejtë vote. Në rastë se kjo mbledhje nuk realizohet, në të dytën nuk kërkohet asnjë lloj kuorumi.

16.4. Kuvendi i zakonshëm merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni 15

E drejta për të u njohur me dokumente

Drejtori duhet të paktën 8 ditë para ditës së caktimit të mbledhjes së Kuvendit të iu dërgojë dokumentet e nevojshme aksionerve për tu njohur dhe për të dhënë një gjykim të plotë, mbi administrimin dhe ecurinë e punëve të shoqërisë në fund të vitit, raportet mbi aktivitetin e shoqërisë, raportin e ekspertit të kontabilitetit, raportin e Këshillit mbikqyrës, të gjitha projekt vendimet dhe konkluzionet si dhe të gjitha dokumentet tjera të parapara me "Ligjin për Shoqëritë Tregtare".

Neni 16

NËPUNËSIT E SHOQËRISË

18.1. Nëpunësit e Shoqërisë zgjedhen nga Drejtori. Shoqëria nuk mund të ketë më pakë se 1 nëpunës.

18.2. Kompetencat e nëpunësve parashihen me aktet normative të Shoqërisë si dhe në marrëveshje me Drejtorin sipas dispozitave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe ligjeve tjera relevante.

Neni 17

DREJTORI

19.1. **Drejtor i Shoqërisë** emrohet :Admir Bytyci me id BA7491039 dhe adrese RR. Osman Myderizi , Tirane, i cili do të ushtroi funksionet e tij/saj nën kontrollin e Kuvendit të aksionerëve.

19.2. Drejtori mund të shkarkohet për shkaqe të cenimit të ligjit nga Kuvendi i aksionerëve. Si shkaqe të cenimit të ligjit konsiderohen veqanërisht një faj i rëndë i Drejtorit ,pa aftësia e tij në kryerjen korekte të funksioneve ose kur Kuvendi humb besimin tek ai.

Neni 18

Kompetencat dhe kufizimet

20.1 Drejtori ka këto kompetenca:

- të paraqitet, përfaqëson dhe nënshkruan për shoqërinë,
- të ekzekutoi Vendimet e Kuvendit,
- të udhëheq afarizmin e shoqërisë,
- të organizon dhe udhëheq me procesin e punës,
- përgatit pasqyrat vjetore te kontabilitetit dhe raportet mbi afarizmin,
- propozon Vendimet të cilat i nxjerr Kuvendi,
- propozon organizimin e brendshëm të shoqërisë,
- i pranon në punë dhe iu shkëput Kontratën e punës punëmarrësve,
- vendos mbi sistemimin e punëmarrësve në vende pune,
- kujdeset për ligjshmerine e punës në shoqëri,
- vendos mbi procedurat disiplinore të të punësuarve,
- kryen edhe punë të tjera në harmoni me ligjin, Statutin dhe Vendimet e Kuvendit.

20.2. Drejtori si përfaqësues i shoqërisë është i autorizuar të lidhe Kontrata dhe kryej të gjitha veprimet tjera juridike pa kurrfarë kufizimesh.

Neni 19

Përfaqësimi

Nga ana ligjore ,Shoqëria përfaqësohet nga drejtori.

Neni 20

NDARJA ,BASHKIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, likuidohet ose transformohet në një formë tjetër, përpara afatit të përcaktuar, me vendim të mbledhjes së jashtëzakonshme të aksionerve, në përputhje me parashikimet e “Ligjit për shoqëritë tregtare”.

Neni 21

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

24.1. Ky Statut hyn në fuqi ditën që e aprovojnë Themeluesit e Shoqërisë.

24.2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas procedurës së njejtë si është aprovuar.

24.3. Për të gjitha qështjet që nuk janë përcaktuar me këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Data: 25.11.2021

Vendi: Prishtine

Themeluesit :
I. Fatbardha Bytyci

